



Prishtinë: 13.06.2018

Kodi i ZRRE-së: V_995_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1795_04_18**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **21.05.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 13.06.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Sh. J., nga Prishtina me shifër **DPR - 90023483** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1773_02_18** i datës 28.02.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 21.05.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori Sh. J., i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë. Konsumatori në ankesën e tyre kanë theksuar se pas faturës së janar 2016 në vlerë prej 6566.82€, është bërë ankesa në KESCO dhe se ekipi i KEDS-it ka dalur në inspektim por nuk kanë lënë asnjë procesverbal të inspektimit edhe përkundër insistimit të konsumatorit. Konsumatori në ankesë ka theksuar se derisa kanë qenë duke pritur përgjigje me shkrim, KEDS-i ka dalur për shkyçje dhe se është atëherë është informuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe se pas insistimit e kanë marrë procesverbalin ku theksohet se kinse konsumatori refuzon nënshkrimin por që realisht procesverballi nuk është dorëzuar asnjëherë. Konsumatori në ankesë ka theksuar se vendimi i ZRRE-së thirret në disa analiza të cilat konsumatori nuk i ka parë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së, ka analizuar dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore të konsumatorit të theksuara në ankesë, por që nuk ka vërtetuar me asnjë element se konsumatori



është i dëmtuar me ngarkesën e bërë për faturimin e bërë gjatë muajit janar 2016 nga Departamenti i Faturimit i KESCO.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të paditësit lidhur me procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0021245 të datës 08.12.2015 të cilën procesverbal e kanë siguruar mbas shumë përpjekjeve, Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes procesverbalin i lartcekur dhe thekson se larguar nga matja grupin matës, ku njehsori aktiv ka qenë me nr.35721478 me gjendje TL=32147.547 kWh dhe TU=20284.672 kWh dhe njehsori reaktiv me gjendje TL=13856.952 kVar dhe TU=11778.591 kVar dhe maksigrafi prej 3.3044 kW, dhe kanë vendosur për matje grupin matës me numër njehsori aktiv nr.51284528 prej TL=00000.00 kWh dhe TU=00000.00 kWh dhe njehsori reaktiv me gjendje TL=00000.00 kVar dhe TU=00000.00 kVar. Vlen të theksohet se në procesverbal gjithashtu është theksuar se njehsori i ri montohet në TS 10/0.4 kV sipas urdhëresës së menaxhmentit, pasi që konsumatori nuk ka bërë përgatitjet e duhura dhe se pas afatit njehsori i vjetër mbetet te konsumatori dhe bëhet montimi i ormanit për njehsor. Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë procesverbalit të lartcekur konstaton se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e grupit matës e evidentuar në procesverbalin e ndërrimit të grupit matës të lartpërmendur përputhet me gjendjen e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike për muajin 12/2015.

Gjithashtu Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë raportit mbi kontrollimin teknik të grupit matës nr.030557 të datës 01.03.2016 dhe rrjedhës së energjisë elektrike aktive, ka vërejtur se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrik nr.51284528 e evidentuar në raportin mbi kontrollimin teknik të grupit matës prej TL=02599.189 kWh dhe TU=01471.605 kWh përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive të periudhës 02/2016 dhe 03/2016.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të paditësit se vendimi i ZRRE-së thirret në disa analiza të cilat konsumatori nuk i ka parë, Bordi i ZRRE-së thekson të gjitha analizat e bëra shpenzimit të energjisë elektrike janë të paraqitura në vendimin e organit të shkallës së parë. Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes rrjedhën e shpenzimit të energjisë elektrike dhe sipas analizave të bëra vërehet se te konsumatori në muajin 11/2011 është vendosur njehsori me nr.35721478 dhe se ky njehsor ka qenë në funksion deri më 12/2015, kur është larguar nga matje dhe është vendosur për matje njehsori elektrik nr.51284528. Bordi i ZRRE-së me qëllim që të paraqet sa me qartë shpenzimet e konsumatorit ka bërë analizimin e shpenzimit të energjisë së konsumatorit me dy njehsorët elektrik dhe ka vërejtur se nuk ka ndryshim në shpenzimin mesatar mujor mes këtyre dy njehsorëve. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrik nr.35721478 prej periudhës 11/2011 e deri më 12/2015 është 20,972.90 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrik nr.5128428 prej periudhës 01/2016 e deri më 12/2017 është 19,040.80 kWh/muaj. Pra, nga kjo shihet se qartë se konsumatori nuk ka rritje të shpenzimit me njehsorin e ri elektrik në krahasim me njehsorin e vjetër.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë procesverbalit mbi montimin dhe demontimin – ndërrimin e grupit matës nr.0021245 të datës 08.12.2015 ka vërejtur se grupi matës nr.51284528 ka filluar të regjistrojë energji elektrike te konsumatori në fjalë (shifra DPR – 90023483) nga kjo periudhë dhe se kontestimi i faturës së energjisë elektrike nga konsumatori ka ardhur për periudhën 01/2016. Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë procesverbalit të lartcekur dhe rrjedhës së energjisë elektrike aktive konstaton se faturimi i energjisë elektrike nga KESCO për periudhën 01/2016 prej TL=31598 kWh dhe TU=17828 kWh paraqet grumbullim të shpenzimit të energjisë elektrike prej datës 08.12.2015 e deri te data 26.01.2016 kur është bërë lexim dhe faturimi i energjisë elektrike të muajit 01/2016. Pra KESCO për muajin 12/2015 konsumatorin në fjalë e ka faturuar me shpenzim prej TL=10173 kWh dhe TU=5481 kWh për njehsorin me nr.35721478 prej periudhës prej datës 24.11.2015 (data e leximit të muajit 11/2015) e deri më datën e ndërrimit të grupit matës 08.12.2015 (procesverbali nr.0021245).



Bordi i ZRRE-së ka analizuar shpenzimet e energjisë elektrike të muajve 12/2015 dhe 01/2016 dhe shpërndahen për dy muaj, atëherë rezulton se shpenzimi mesatar mujor është TL=20886.20 kWh dhe TU=11654.50 kWh, dhe nëse krahasohen me shpenzimet e muajve para dhe pas këtyre periudhave rezulton se nuk dallon shumë me shpenzimet tjera me njehsorin e vjetër dhe me njehsorin e ri. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ka bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike për muajt e lartcekur dhe ka rezultuar se nuk ka elemente të korigjimit financiare e cila duhet t'i bëhet konsumatorit.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit Sh. J. dhe
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.